

VENDIM
Nr. 191, datë 6.6.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË
BARRËS SIGURUESE) TË ASETVE TË PALUAJTSHME TË CENTRALIT
FOTOVOLTAIK “BLUE 1” NË FAVOR TË “GREEN FOR GROWTH FUND
SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF”**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, germa “b”, dhe nenit 10 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/6 prot., datë 1.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘SPV BLUE 1’ sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 7.4.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1135/2 prot., datë 14.4.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje, ndërsa me shkresën nr. 1135/3 prot., datë 18.4.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/4 prot., datë 11.5.2023, depozitoi në ERE dokumentacionin plotësues.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi është plotësuar tërësisht si vijon:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”:

Pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, plotësuar;

Pika 3: plotësuar;

Pika 6: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve të paluajtshme të centralit

fotovoltaik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF” (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

SPV Blue 1

Rr. Themistokli Gërmenji, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 48 13 427



BLESSED
INVESTMENT



MATRIX
KONSTRUKSION

ANEKSI 1

LISTA E ASETVE TË SHOQËRISË "SPV BLUE 1" SH.P.K.

Nr.	PËRSHKRIMI	SASIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE	VLERA (EURO)
1.	Panel Diellor	103,554	TSM-DEG21C.20 Vertex Dual G lass Bifacial Monocrystalline 650 Wp and 655 Wp	€ 17,659,431
2.	Inverter	177	SG350HX-V115_S Five-hole TB_SG320HX_S_A	€ 2,492,580
3.	Transformatorë	6 1	MVS8960-LV MVS3200-LV	€ 1,538,750
4.	Pilota	19,229	Mikro-pilota ne beton C25/30	€ 1,221,301.91
5.	Struktura	1,832	Tracker VANGUARD 1P	€ 4,702,164.09
6.	Kablo dhe Aksesore (Pajisje LV) + Scada + Sistem CCTV	1,020,361 m	Kablo diellore/Kablo gjenerimi /Kablo për shërbime ndihmëse /Kablo të tensionit të lartë/ Togëzim/Struktura/Kuti kryqëzimi/Ndërtesa/Porta	€ 1,429,867
VLERA TOTALE (EURO)				€ 29,044,094

SPV Blue 1 sh.p.k.

Zenel Hysenbegasi

Zenel Hysenbegasi
Administrator



Rr. Themistokli Gërmenji, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri

Të drejtat e autorit rezervuar. Ky dokument nuk mund të riprodhohet, publikohet ose vihet në dispozicion të palëve të treta pa pëlqimin paraprak të SPV Blue 1 sh.p.k. Fajta 4 - 4